

Faza e parë
Debate publike për procesin e hartimit të Kushtetutës së Kosovës

Vendi: Gjilan (2 shkurt, 2008) / Kuvendi Komunal

Panelistët: Ilaz Ramajli, Kadri Kryeziu

Fjala e panelistëve: (përmbledhje e shkurtë e diskutimit)

Ilaz Ramajli: (Anëtar i Komisionit Kushtetues)

Në komisionin kushtetues për hartimin e Kushtetutës janë emëruar 21 vetë, por nëngrupet e komisionit kushtetues kanë qenë dhjetë të cilët kanë draftuar pjesë të caktuara të kushtetutës. Kanë qenë të inkuadruar një numër shumë i madh i ekspertëve vendorë, por kemi pasur ndihmë të jashtëzakonshme edhe nga ekspertë të ShBA-ve që kanë ardhur për të na ndihmuar përmes USAID, dhe gjithashtu gjatë punës së komisionit kanë ndihmuar një numër i konsiderueshëm i ekspertëve evropianë.

Në takimet e para që po zhvillohen nëpër komunat e Kosovës, do të njoftohen qytetarët për procesin se si do të rrjedh procesi i bërjes dhe nxjerrjes së Kushtetutës. Pasi që Komisioni Kushtetues ta këtë përcaktuar draftin final të Kushtetutës së Kosovës, do të fillojë faza e dytë e diskutimeve me qytetarë ku ata do ta kenë draftin e Kushtetutës. Ata do të kenë mundësi të japin mendimet dhe sugjerimet e tyre, të cilat, Komisioni Kushtetues përmes grupeve punuese, do t'i rishikojë të gjitha vërejtjet dhe do të vlerësojë se sa është e mundur që të inkorporohen.

Kadri Kryeziu:

Komisioni i emëruar nga presidenti i Kosovës dhe ka mandat për dizajnimin dhe strukturimin e Kosovës dhe ta plasojë atë në këtë debat publik të qytetarëve të Kosovës. Parimet bazë për hartimin e kushtetutës së re të Kosovës janë marrë si: shprehja e vullnetit të popullit të Kosovës, respektimi i të drejtave dhe lirive të minoriteteve, dhe inkorporimi i pakos së Ahtisarit si dokument i domosdoshëm që është e obligueshme që ta zbatojmë në Kosovë me rastin e implementimit të këtij dokumenti. Kushtetua përmban 14 kapituj, afro 150 nene dhe secili kapitull dhe nen ka diçka të veçantë që ndihmon dhe rregullon jetën e qytetarëve të Kosovës.

Pyetjet / komentet e qytetarëve

Qytetari: Si e kuptoni diskriminimin pozitiv, si do të zgjidhet kjo çështje?

Kadri Kryeziu: Ne do të fitojmë me këtë kushtetutë. U kemi dhënë disa të drejta minoriteve më shumë sesa i kanë në vendet e tyre të përcaktuara me kushtetutë minoritetet. Siç e kuptoni gjuhë zyrtare në Kosovë do të jetë gjuha shqipe dhe serbe, por të drejtë të përdorimit të gjuhës së tyre do të kenë edhe minoritetet tjera. Në këtë komision marrin pjesë të gjithë përfaqësuesit e partive politike, të shoqërisë civile, përfaqësues të NATO-s, TMK-së, etj. Me kushtetutën e re Kosova do të ketë ushtrinë e vet, policinë e vet, Shërbimin e Inteligjencës, dhe Kosova do të jetë shtet sovran. Dihet se serbët kanë kërkuar 18 komuna, kurse Grupi i Unitetit i cili ka marrë pjesë në këto takime ka qenë këmbëngulës që kjo të mos ndodhë. Në Gjilan do të ketë tri komuna sipas Pakos së Ahtisarit, Novobërda, Parteshi dhe Gjilani.

Sipas Pakos së Ahtisarit, kryetari i komunës ka më shumë kompetenca. Në gjithë ekzekutivin parashihet që ministritë t'i udhëheqin minoritetet, por kjo nuk do të pengojë zhvillimin e vendit.

Qytetari: Do të ishte mirë ta kishim draftin. Si parashihet struktura e personelit gjyqësor? Si do të organizohet pushtetit i gjyqësorit sipas Kushtetutës së re?

Kadri Kryeziu: Komisionin për gjykata e ka udhëheqë Nekibe Kelmendi. Ndërsa sa i përket shpalljes së Pavarësisë, ajo do të bëhet në Kuvendin e Kosovës, kurse Kushtetuta është e dizajnuar, është gati. Debati që po bëhet sot është pjesë e informimit. Kushtetuta është shprehje e vullnetit të qytetarëve. Pushteti gjyqësor do të barazohet me dy pushtetet e deritashme, do t'i garantohet një garanci e veprimit të tij. Kushtetuta do të kalojë në Kuvend me 2/3 e votave. Janë 19 ligje bazike nga Pakoja e Ahtisarit. Për herë të parë Kosova do të ketë Gjykatën Kushtetuese (Supreme).

Ilaz Ramajli: Shqetësimet tuaja i kemi pasur edhe në si grupe punuese për gjyqësorin. Si grupe punuese kemi ardhur në përfundim që në hartimin e Kushtetutës së re të përdorim modelet e kushtetutave më moderne, duke angazhuar grupet më profesioniste në këtë drejtim. Kemi zgjedhur modelin më të përshtatshëm për Kosovën. Sa i përket llojit të gjykatave, ajo do të rregullohet me ligj. Gjykatat kanë mundësi të menaxhojnë me buxhetin, pra buxheti i takon gjyqësorit, Këshillit të Gjyqësorit.

Qytetari: Kërkoj që në ueb-faqe të futen terma për sqarim. A e parasheh Kushtetuta e re e Kosovës të drejtën e referendumit?

Ilaz Ramajli: Kushtetuta e parasheh të drejtën e referendumit, por në praktikën e kushtetutave të vendeve të ndryshme të botës nuk është shumë obligative çështja e Referendumit. Dihet se Kosova ka pasur njëherë Referendum për pavarësi. Vullneti i popullit mund të shprehet edhe përmes të zgjedhurve të popullit. Dihet se është vështirë që teknikisht të organizohet referendumi, aq më tepër kur kihet parasysh çështja e ngutshme që po e pret Kosovën në prag të pavarësisë së saj dhe rrethanave të krijuara. Gjithashtu dihet se për të hyrë në fuqi një vendim i tillë duhet të nënshkruhet nga Përfaqësuesi Special i Kombeve të Bashkuara.

Qytetari: Si është i rregulluar mandati i presidentit në Kushtetutën e re?

Kadri Kryeziu: Me kushtetutë është paraparë që kryetari i Kosovës të ketë mandat pesëvjeçar me kompetenca të sforcuara.

Qytetari: Çka kuptoni me fjalën diskriminim pozitiv, dhe a do të ishte më mirë që të mos përdorej termi as pozitiv as negativ, por të bëhej një baraspeshë, një barazim?

Ilaz Ramajli: Termi diskriminim pozitiv është term foljor, por kjo nuk është e përmendur në Kushtetutë. Ne nuk mund t'i ndryshojmë obligimet që i kemi ndaj Bashkësisë Ndërkombëtare. Dihet se ka pasur njerëz që kanë sakrifikuar, por për hir të interesave më të mëdha kanë bërë kompromise me BE-në.

Qytetari: Ne në Gjilan nuk e kemi pranuar decentralizimin?

Kadri Kryeziu: Politika nuk është bardhë e zi. Kompromisi është bërë dhe këtë e ka pranuar shefi yt i partisë.

Qytetari: Me çfarë mekanizmash parashihet mbrojtja dhe siguria e Kosovës sipas Kushtetutës?

Kadri Kryeziu: Kufijtë e Kosovës do t'i ruajë KFOR-i, kurse për ruajtjen e tërë territorit të saj do të angazhohen KFOR-i, SHPK-ja, TMK-ja.

Qytetari: Me kushtetutën e re si është e rregulluar çështja e flamurit, stemës dhe himnit? A rregullohet zgjedhja e kryetarit të Kosovës me Kushtetutë? Dhe kam një propozim që kryetari i Kosovës të zgjedhet nga populli. A është paraparë çështja e pranisë së forcave të jashtme në Kosovë, dhe dërgimi i forcave të Kosovës jashtë saj?

Ilaz Ramajli: Çështja e himnit, flamurit dhe simboleve të Kosovës është e rregulluar me kushtetutë dhe ligj. Zgjedhja e kryetarit është mekanizëm që mua personalisht më është dukur i përshtatshëm. Për kryetar mund të kandidohet çdo qytetar i Kosovës edhe nëse nuk është anëtar i ndonjë subjekti politik, por që duhet t'i ketë nënshkrimet e 30 anëtarëve të Kuvendit të Kosovës. Mënyrën e zgjedhjes së kryetarit e ka përcaktuar Grupi i Unitetit.

Kadri Kryeziu: Me kushtetutë janë paraparë simbolet e Kosovës, flamuri, stema dhe himni. Dihet se për këtë ka pasur konkurs me disa dispozita. Flamuri i Kosovës do të jetë flamur i të gjithëve, do të jetë flamur i Kosovës, por do të ketë të drejtë të përdoret edhe flamuri kombëtar. Kosova sipas Kushtetutës së re do t'i ketë 2500 ushtarë dhe 800 rezervë të cilët do të mbikëqyren nga Ministria e Mbrojtjes. Pas njohjes së Kosovës dhe anëtarësimit të saj në NATO, Kosova ushtarët e saj do t'i angazhojë në NATO (në kuadër të saj). Ushtarët e Kosovës do të jenë pjesë e NATO-s.